



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I GJEOLGJISË DHE I MINIERAVE
DEPARTAMENTI I BURIMEVE TË ENERGJISË



Tiranë, më 16.05.2023

L A J M Ë R I M

Mbi Regjistrimin dhe Kontrollin e Diplomave për Vitin Akademik 2022 – 2023
SEZONI I VJESHTËS

Rektori i UPT përmes shkresave “Struktura Vjetore e Procesit Mësimor për Programet e Studimit të Ciklit të Parë dhe Programet e Integruara të Studimit të Ciklit të Dytë, për Vitin Akademik 2022-2023” (Nr.2041 i Protokollit UPT, datë 19.09.2022), “Struktura Vjetore e Procesit Mësimor për Programet e Studimit të “Master i Shkencave” dhe “Master Profesional”, për Vitin Akademik 2022-2023” (Nr.2269 i Protokollit UPT, datë 16.10.2022) dhe “Ndryshime në Strukturën Vjetore të Procesit Mësimor në Semestrin e Dytë të Vitit Akademik 2022-2023” (Nr.559 dhe 559/1 të Protokollit UPT, datë 02.03.2023), ka shpallur Sezonin e Mbrotjes së Diplomave dhe dhënies së Provimit të Formimit – Sezoni i Vjeshtës – Viti Akademik 2022-2023, në periudhën 25.09 ÷ 11.10.2023.

Njoftohen studentët e Programit të Studimeve “Bachelor”, “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave” për diplomat që administrohen nga Departamenti i Burimeve të Energjisë që deri në **datën 30 QERSHOR 2023 të regjistrojnë Temën e Diplomës¹ dhe emrin e Udhëheqësit përkatës² pranë Sekretares së Departamentit të Burimeve të Energjisë (zyra e DBE, Nr. 405)³.**

Studentët e mësipërm njoftohen se në mbështetje të Rregullores së FGJM dhe DBE në **datën 08.09.2023, duke filluar nga ora 08:30** do të bëhet **KONTROLLI I PARË** i punës për përgatitjen e Temës së Diplomës. Studentët që kanë regjistruar brenda afatit Temat e Diplomës duhet të paraqesin pranë **Departamentit të Burimeve të Energjisë (zyra e DBE):**

1. Strukturën Paraprake të Temës së Diplomës;
2. Literaturën (titujt);
3. Materialet në versionin fillestar të tyre.

Studentët që kanë kaluar me sukses Kontrollin e Parë të Temës së Diplomës, në datën 15.09.2023, duke filluar nga ora 08:30 do të nënshtrohen Kontrollit të Dytë të saj. Ata duhet të paraqesin pranë **Departamentit të Burimeve të Energjisë (zyra e DBE):**

1. Strukturën Përfundimtare të Temës së Diplomës;
2. Literaturën e plotë;
3. Materialet e plota (mund të pranohen edhe në variantin bruto)⁴.

Studentët duhet të tërheqin pranë DBE Udhëzuesin mbi strukturimin e temave të Diplomave. **VETËM STUDENTËT QË KANË KALUAR ME SUKSES TË DY KONTROLLET E MËSIPËRM, KRAHAS DETYRIMEVE TË TJERA TË PARASHIKUARA NË AKTET LIGJORE DHE NËNLIGJORE NË FUQI, DHE E KANË STRUKTURUAR SIPAS KËRKESAVE TË UDHËZIMIT TEMËN E DIPLOMËS, DO TË FITOJNË TË DREJTËN PËR TU FUTUR NË MBROJTJEN E SAJ, PËRPARA KOMISIONIT PËRKATËS.**

¹ Regjistrimi mund të bëhet edhe on-line në adresat: nevtan.kodhelaj@fgjm.edu.al; preso_4@yahoo.com; nevina.koja@fgjm.edu.al.

² Rekomandohet që udhëheqësi i propozuar të jetë Pedagog Efektiv/i Ftuar pranë UPT/FGJM/DBE.

³ Ky afat vlen edhe për Studentët e prapambetur nga Diploma të tjera pranë DBE.

⁴ Pas këtij kontrolli Studentit do ti mbetet vetëm hedhja në të pastër e materialit, printimi, dorëzimi i saj si edhe përgatitja e prezantimit.

DEPARTAMENTI I BURIMEVE TË ENERGJISË

Adresa: Rruga e Elbasanit, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2375246/5, web: www.fgjm.edu.al; e-mail: departamentiburimeveenergji@fgjm.edu.al